

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Një njeri i zakonshëm nuk mund ta ketë atë buzëqeshje pas atij vendimi"/ Përlotet vajza e Jakup Krasni qit: Ja mesazhi që na ka lënë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajon/nje-njeri-i-zakonshem-nuk-mund-ta-kete-ate-buzeqeshje-pas-atij-vendimi-pe-i586677
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 12:12:45 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 12:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0aa0c3ad689cd3733a12fb467769e26aa6b754545f510887d8e795543be68a78
TEKSTI	268382e40a0e822f62ea7191cf9307db46363fa902d63604e572eb971f100c43
PAMJA	ecdda539d4699e3393dcf3dffd22499ae080928cf80d77ea53493dc6f255a327

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b8728633155059def0f49dc48198e6ea66e1069a7df4402a4253a21afbe84b81
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c459fbdf88f453b54a4131a2c6b72ae8533f09b2deef09d60e250bd91e1b553d
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/b8728633155059def0f49dc48198e6ea66e1069a7df4402a4253a21afbe84b81

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

le Konferenca "Irrana Fire Safety 2026", Ministri Nuh: "Mbrotja civile nuk mund te ndertohet vetem mbi reagimin, duhet parandalim" Ministrja Shendetesise, Spahiu ne Ki fundit

“Një njeri i zakonshëm nuk mund ta ketë atë buzëqeshje pas atij vendimi”/ Përlotet vajza e Jakup Krasniqit: Ja mesazhi që na ka lënë



17 Shtator 2026, 14:40Rajoni TEMA



Vajza e Jakup Krasniqit, Gresa, foli ekskluzivisht për Top Channel pas vendimit të Gjykatës Speciale të Apelit për liderët e UÇK-së.

Në një intervistë për Top Channel, Gresa Krasniqi shprehet se Gjykata Speciale është ‘gatuar’ në Beograd dhe se i ati i saj ka qenë gjithmonë kundër, gjë që sipas saj ka ndikuar dhe në masën e ashpër.

“Shpresonim që do ishte një vendim lirues, megjithatë duke patur mënyrën se si është arrestuar babi dhe mënyra se si është zhvilluar procesi në atë gjykatë, në mënyrë aq të padrejtë, kmi qenë duke pritur një vendim që do t'i shpallte fajtor. As që e kishim paramenduar një dënim kaq të madh. Duke pasur parasysh komandantë aq të mëdhenj të Serbisë që kanë bërë krime dhe gjenocide në Ballkan, kanë marrë dënime shumë herë më të ulëta.

Është një e vërtetë e pamohueshme që Gjykata Speciale është formuar në parlamentin e Kosovës, por në fakt është gatuar në Beograd dhe me mbështetësit e tyre. Mendoj se këtu vjen natyrshëm shpjegimi pse u dha një dënim mizor dhe kaq i madh për krerët e UÇK-së.

Në kohën kur është votuar Gjykata Speciale, babi nuk ka qenë fare pjesë aktive e politikës, pavarësisht disa videove që qarkullojnë në rrjetet sociale dhe kanë më tepër qëllim propagandistik. Mbaj mend që në atë periudhë, ndër zërat që e kanë kundërshtuar vendimin për Gjykatën Speciale ka qenë vetë babi. Mendoj se themelimi i saj ka qenë i domosdoshëm.

Ai ka qenë absolutisht kundër. Dje po bisedonim në Zoom dhe na tha se një ndër arsytet pse mori një dënim kaq të madh ishte sepse ishte kundër themelimit të kësaj Gjykate. Babi nuk ka qenë fare pjesë aktive e politikës kur është themeluar Gjykata Speciale.

Është njeri i jashtëzakonshëm, sepse një njeri i zakonshëm nuk mund ta ketë atë krenari, atë buzëqeshje”, tha ndër të tjera Gresa Krasniqi.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["Jo në emrin tonë1" / Studentët në Prishtinë marshim proteste në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së](#)

13:30 Rajoni

[Ballkani nën kërcënimin e Serbisë? Paralajmëron gjenerali amerikan: Ka vende të tjera që përfitojnë](#)

11:20 Rajoni / 2 komente

"Me kokën lart, babë. Gjithmonë", djali i Jakup Krasniqit me mesazh prekës një ditë pas verdiktit

10:20 Rajoni

Cilat janë hapat që ndërmerren për apelimin e një vendimi të Gjykatës Speciale?

09:00 Rajoni



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.